



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:247195

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05541107

C.nr.1119/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.K nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës, me datë 03.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses A.K, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 1,383.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 08.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm”.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit A.K, t'ia paguajë shumën prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.K, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 13.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura. Paditësit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili ka qenë në fuqi deri më datën 06.02.2023, për periudhën kohore nga data 01.01.2021 e deri më 31.01.2023 nuk i është llogaritur në pagë diferenca në pagë sipas vendimit të qeverisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 09.02.2024, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë e vetme në këtë çështje kontestimore, ngase sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, në nenin 8 është përcaktuar se “Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”. Në asnjë pikë të vendimit të përshkruar nuk është obliguar Komuna e Rahovecit që të zbatojë këtë vendim. Më tej ka shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës pa numër të protokollit, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; diplomën me numër 362 e datës 18.02.2009 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës; aktvendimi mbi licencimin e mësimdhënësit Nr. 1008420 e lëshuar më datën 26.12.2012 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për paditësen dhe listën e pagave për muajin tetor 2022 për paditësin.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja kishte të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësja posedon licencë të mësimdhënësit. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëses kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe kualifikimit dhe a është parashkruar kërkesa e paditëses.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës pa numër të protokollit, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.K kishte të themeluar marrëdhënien e punës te e paditura, me kontratë të përhershme.

Me administrimin e diplomës me numër 362 e datës 18.02.2009 e lëshuar nga Fakulteti i Arteve i Universitetit të Prishtinës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.K ka përfunduar Fakultetin Arteve në Universitetin e Prishtinës më datën 21.10.2008 dhe mori titullin skulptor i diplomuar.

Me administrimin e licencës së aktvendimi mbi licencimin e mësimdhënësit Nr. 1008420, e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për paditësen A.K, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është licencuar me licencë të mësimdhënësit nga data 26.12.2012.

Me administrimin e listës së pagave për muajin tetor 2022 për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se në muajin tetor të vitit 2022, paditësja A.K në këtë periudhë kishte pagën bazë prej 421 euro, ndërsa në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t'i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parasheh *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e saj e aprovoi në tërësi pasi që është e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditëseve është dorëzuar më datën 13.11.2023, ndërsa kërkesëpadia e paditëses përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.01.2023. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditëses shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 135.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 31.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.1119/2023, më datë 03.04.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.